

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA VAU I DEJËS



HAPA TË LEHTË
QERSHOR 2022

Tabela e përmbajtjes

1.Hyrje	2
2.Koncepte dhe përkufizime	3
3.Profili i Bashkisë	4
4. Metodologjia.....	6
5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik	7
6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak.....	11
7. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë.....	16
8. Konkluzione.....	26
9. Rekomandime.....	27

1. Hyrje

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse në Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

2. Koncepte dhe përkufizime

BP	Buxheti me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Plame International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

3. Profili i Bashkisë

Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës. Sipas Censusit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30,438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë¹. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Bashkia e Vaut të Dejës pas reformës së vitit 2014, zgjerohet me 5 komuna, për të cilat fusha kryesore e zhvillimit është bujqësia, ndërsa e gjithë zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit. Njësia Administrative Bushat, është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, NJA Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës, të cilat perceptohen pa lidhje historike me bashkinë e re dhe janë veçanërisht pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmytur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës. Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

Qeverisja vendore

Gjendja aktuale e qeverisjes vendore është produkt i dinamikës së një sërë reformash institucionale për decentralizimin dhe autonominë vendore. Procesi i decentralizimit dhe i autonomisë vendore u materializua edhe më tej me miratimin e Kushtetutës dhe nënshkrimin e Kartës Europiane për Autonominë Lokale. Me miratimin e ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ndarja e re territoriale përcakton si njësi të qeverisjes vendore 61 bashki dhe 12 qarqe. Bashkia e Vaut të Dejës përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Shkodrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra. Popullsia prej 50 130 2banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në Njësinë Administrative Bushat me 24,200 banorë.

¹ <https://aam.org.al/bashkia-vau-i-dejes/>

² <https://www.vaudejes.gov.al/rreth-nesh/>

Bashkia Vau –Dejës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qytetet Vau Dejes, Fshatrat; Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe	30,438	50,042	468,00
		Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
		Vig-Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig			
		Hajmel	Fshatrat; Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë			
		Temal	Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë			
		Shllak	Fshatrat; Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj			

2.Profili ekonomik

Aktiviteti kryesor ekonomik është bazuar në bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogël dhe shërbimet. Vau-Dejes gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit të energjisë ,me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2 . Në bashkinë e Vau te Dejes ndodhet dhe Landfilli rajonal i Bushatit ,si pike grumbulimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Vau Dejes -Lezhë Njësitë administrative Shllak dhe Temal ndikohen nga përmbytjet e shkaktuara nga fryrjet e ujerave të liqenit Vau Dejes , çka ndikon në reduktimin e prodhimit bujqësor.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore.Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës. Sipas të dhënave të bashkisë në faqen zyrtare www.bashkiavaudejes.gov.al të regjistruara janë 449 biznese të vogla,TVSh dhe 101 biznese të mëdha.

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmbytjet. Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vaut të Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vaut të Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau i Dejës deri në Koman.

4. Metodologjia

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Vau i Dejës janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdreshin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik

Me hyrjen në fuqi të Reformës së re Administrativo - Territoriale, ligji nr.115/2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, ofrimi i shërbimeve për qytetarët, kërkon implementimin e një sistemi informatik, i cili zbaton procedurat e miratuara paraprakisht nga Bashkia (rregulloren e shërbimeve administrative dhe manualin përkatës). Bashkia Vau Dejës ofron shërbime sipas modelit të zyrave me një ndalesë në NJA duke garantuar kosto të ulët shërbimi dhe kohë më të shkurtuar. Komunikimi i vazhdueshëm dhe shkëmbimi informacionit është një ndër elementët kryesorë për të rritur besimin e qytetarëve dhe transparencën e institucioneve të nivelit vendor dhe qendror. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes së detyrimeve për të drejtën për informim.

Ndër elementët kryesorë për të mbajtur një publik të informuar janë edhe mediat e ndryshme të cilat ndiqen nga qytetarët. Përdorimi i teknologjive të reja dhe mediave sociale ka shtuar ndjeshëm nivelin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut, aktorëve politikë e publikë me publikun dhe anasjelltas. Nga analiza e bërë disa nga metodat që përdor Bashkia Vaut Dejës janë:


Zyra me një Ndalesë

Është kontakti i parë me qytetarët sapo futesh në bashki. Në Njësitë Administrative nuk ka zyra me një ndalesë. Në këtë zyrë punonjësit merren me problematikat dhe çështjet e qytetarëve duke i drejtuar ato në strukturat përkatëse për zgjidhje. Shërbimet e zyrës me një ndalesë lehtësojnë marrëdhënien e qytetarëve dhe bizneseve, për një sërë grup shërbimesh administrative si: vërtetime, kërkesa, ankesa, aplikime për leje dhe autorizime të ndryshme, marrje informacioni etj. Pranë Zyrës me një ndalesë, bëhen edhe kërkesat apo shkresat për informim drejtuar Bashkisë.

Faqja Web e Bashkisë Vau Dejës

Bashkia Vau Dejës, ka faqe në web e cila është e ndërtuar më shumë mbi bazën e dhënies së informacionit në formën e shkruar dhe shikohet si një nga mënyrat e cila bashkia komunikon me qytetarët. Përveçse shërben edhe për të nxjerrë në pah elementë të bukur të bashkisë me foto të qytetit, më e rëndësishme në faqe ka informacione të ndryshme për: bashkinë, këshillin bashkiak, programin e transparencës, shpallje apo njoftime, informacione rreth Vau Dejs-it për biznesin, për qytetarët, etj. Në këto faqe nuk ka të publikuar rrjete të tjera sociale ku mund të merret informacion rreth bashkisë. Faqja është e lehtë dhe miqësore por vetëm për personat që dijnë të përdorin rrjetet sociale. Faqja nuk përditësohet shumë. Informacioni në lidhje me punën e Këshillit Bashkiak është i plotë. Vlen për tu theksuar fakti se Bashkia Vau Dejës nuk ka një televizion lokal por informacionet shpërndahen nepërmjet televizioneve lokale të Bashkisë Shkodër.

<https://www.vaudejes.gov.al/>



Rrjeti Social Facebook

Faqja zyrtare në facebook e bashkisë menaxhohet nga punonjësit e IT në këtë bashki. Në këtë faqe ka rreth 392 ndjekës, dhe bashkia e përdor si një platformë tjetër komunikimi dhe informimi për qytetarët. Nga monitorimi që është bërë postimeve në këtë faqe konstatohet që ajo shërben më së shumti për promovimin e turizmit. Postimet janë të përbëra nga foto dhe tekst të cilat tregojnë aktivitetet të ndryshme të bashkisë, përfundimin e projekteve të ndryshme, takime ose mbledhje si dhe promovimin e pikave të ndryshme turistike.



Komunikimet e drejtpërdrejta

Komunikimi i drejtpërdrejtë ose ndryshe ballë për ballë është një nga mënyrat më të përdorura por ndoshta edhe më të besueshme në transmetimin e mesazhit. Komunikimin ballë për ballë bashkia Vau Dejës e realizon përmes dëgjësave publike por edhe takimeve me punonjës të sektorëve të ndryshëm në ditë të caktuara, për çdo problematik apo çështje që kanë qytetarët.

Regjistri elektronik

Bashkia në faqen zyrtare, Web-site të saj ka një Rregjistër elektronik -Ankese/Kërkese të Këshillit. Gjithsej ka të publikuara 7 kërkesa/ankesa, 5 janë të vitit 2020 dhe 2 janë të vitit 2021. Ai është i përditësuar për herë të fundit me kërkesën e datës 08.09.2021. Rezulton se vetë dy kërkesa janë mbështetur nga Këshilli Bashkiak.

Rregjistri Ankese/Kerkese e Keshillit

Nr Kërkesë Ankese Ceshlja	Data e Regjistrimit në Protokollin e Bashkisë	“Organi/drejtoria/ sektori që i është dërguar ankesa/ kërkesa (Nr. prot të brendshëm)”	“Dërgimi për mendim në Komisionin përkatës të Keshillit (Nr. prot të brendshëm)”	Kaluar në Këshill për shqyrtim (data)	“Mbështetur nga Këshilli (kërkesa, ankesa) Po/Jo	“Zbatuar nga Ekzekutivi (Data)”
Nr.6 Kerkese per hapje rruge	18.05.2020	Keshillit Bashkiak, Nr. 2582 Prot	Jo	Jo	Jo	-
Nr.4 Mungese Sherbimi Shendetesor	19.05.2020	Keshillit Bashkiak, Nr. 2586 Prot	Jo	Jo	Jo	-

<https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-ankese-kerkese-e-keshillit/>

Programi i transparencës


Në web- site është publikuar vendimi për ngritjen dhe funksionimin e programit të transparencës.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës, me vendim nr.108, datë 24.12.2018 ka miratuar “Programin e Transparencës” të Bashkisë.në bazë të pikes 6 të këtij programi , rishikimi i këtij programi bëhet çdo katër vjet.

Në web -site është publikuar plani i zhvillimit të territorit i viti 2017, si dhe vendimi nr.3, datë 27.04.2018 “Për miratimin e planit të pergjithshëm vendor’. Janë publikuar datat e konsultimeve publike për periudhën Janar-Shtator 2021. Gjithashtu, është publikuar struktura e pagave e vitit 2022, organigrama e Bashkisë.Nuk ka të publikuar raporte në lidhje me transparencën.


6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak

Anketimi me përfaqësues nga Këshilli Bashkiak synon të sjellë situatën aktuale në lidhje me pjesëmarrjen qytetare në procese konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe mënyrat të cilat përdor institucioni në informimin e qytetarëve. Në Bashkinë Vau Dejës janë realizuar 6 intervista me anëtarë të këshillit Bashkiak (Kryetari Këshillit, Sekretari si dhe anëtarë te disa komisioneve). Të ndarë sipas gjinisë intervistat janë realizuar me pjesëmarrjen e shprehur në % përqindje sipas këtyre dy gjinive;



Rëndësia e njoftimit në vendimmarrjen vendore


Në zbatim të detyrimeve të parashikuar në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në Bashkinë Vau Dejës të anketuarit e Këshillit Bashkiak janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore, duke e cilësuar të gjithë 100% si një proces shumë të rëndësishëm.



Rëndësia e informimit në vendimarrjen vendore

Rëndësia e informimit në vendimmarrjen vendore për të gjithë punonjësitë e bashkisë vlerësohet si një proces shumë i rëndësishëm. E drejta për informim është e garantuar në përputhje me ligjin 119/2014, ku secili mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë.


Ashtu siç rezulton edhe nga grafiku, 83% e te intervistuarve anëtarë të KB e kanë konsideruar shumë të rëndësishëm informimin në vendimarrjen vendore ndërsa, 13 % e kanë konsideruar të rëndësishëm.



Rëndësia e konsultimit në vendimarrjen vendore

Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik” si dhe ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen efektive gjithëpërfshirëse të komunitetit në qeverisjen vendore.

Të anketuarit e vlerësojnë si një proces shumë të rëndësishëm konsultimin me publikun, po ashtu nga monitorimi Bashkia Vau Dejës e ka realizuar këtë proces. Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik




duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi, konsultimi dhe pjesëmarrja.

Ashtu siç rezulton edhe nga grafiku, 83% e të intervistuarve anëtarë të KB e kanë konsideruar shumë të rëndësishëm informimin në vendimarrjen vendore ndërsa, 13 % e kanë konsideruar të rëndësishëm.

Baza ligjore dhe korniza rregulluese referuese


Njohuria mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore, rreth 67% e të intervistuarve janë përgjigjur se e njohin shumë mirë, ndërsa 33% e të intervistuarve janë përgjigjur se e njohin mirë. Ndërsa, mbi vlerësimin e kuadrit ligjor 83% e të intervistuarve janë shprehur se është i qartë dhe i plotë, ndërsa 17% janë shprehur se është i qartë por jo i plotë .



Rregulloria e Këshillit Bashkiak përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Këshillit Bashkiak Vau Dejes, procedurën e miratimit të vendimeve të Këshillit, të veprimtarisë vendimarrëse, përfaqësuese dhe mbikqyrëse të Këshillit, monitorimin e procesit të zbatimit të vendimeve të Këshillit, si dhe

marredhëniet e Këshillit me Kryetarin dhe administratën e Bashkisë, me institucionet, agjencitë qeveritare qendrore dhe rajonale, komunitetin, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe strukturat komunitare, përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe realizimin e detyrave të dhëna me ligj dhe ato për të cilat Këshilli ka diskrecion ligjor si dhe rregullat për interpretimin dhe ndryshimin e Rregullores.


Hartimi dhe zbatimi i rregullores realizohet në zbatim të Ligji nr. 8548/1999, neni 4/2 si dhe Ligji nr. 139/2015, neni 7/2. Nga plotësimi i pyetësorëve rezulton se të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak janë në dijeni të Rregullores së Këshillit Bashkiak. Në lidhje me mbledhjet e Këshillit Bashkiak, publiku njoftohet nepërmjet web-it të Bashkisë, afishimit në kënde publike si dhe rrjeteve sociale, minimalisht 5 ditë përpara realizimit të mbledhjes. 83% e anëtarëve të Këshillit Bashkiak të intervistuar, shprehen se kjo rregullore është e qartë dhe e plotë ndërsa, 17% e tyre e konsiderojnë të qartë por jo të plotë.



Në lidhje me sugjerimet se çfarë mund të përmirësohet në këtë rregullore për të qenë më e plotë, meqënëse vetëm një anëtar nga të intervistuarit rezulton se e konsideron rregulloren të qartë por jo të plotë vetëm ai ka preferuar të bëjë koment duke sugjeruar që të gjitha ankesat e publikut apo grupeve të interesit të sillen në Këshill Bashkiak dhe të shqyrtohen.

Të intervistuarit shprehen se ka bashkëpunime midis Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë. Këto bashkëpunime realizohen nepërmjet publikimit të njoftimeve dhe vendimeve në këndin e transparencës pranë Bashkisë si dhe kur ato diskutojnë, punojnë apo bashkëpunojnë me përgjegjësit e sektorve si anëtarë, kryetar të Komisioneve të ndryshme.

Mjetet që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin e publikut




Të gjithë anëtarët e intervistuar shprehen se njoftimi për mbledhjen e Këshillit Bashkiak janë të aksesueshme dhe publikohen në vende të caktuara minimalisht 5 ditë para zhvillimit të Mbledhjes dhe se ky njoftim përmban datën orën, vendin dhe rendin e ditës. Nga përgjigjet shihet se pothuaj të gjitha format për njoftim përdoren nga Këshilli Bashkiak.

Programi Transparencës

Të gjithë anëtarët e intervistuar shprehen se Bashkia ka hartuar dhe publikuar programin e transparencës dhe se raportet vjetore të punës së këshillit Bashkiak për transparencën në procesin e vendimarrjes hartohen dhe publikohen .

Publikimi i programit të transparencës




Të gjithë anëtarët e intervistuar janë shprehur se kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik. Disa nga anëtarët e intervistuar shprehen se, përsëritja e trajnimeve mund të jetë gjë positive ashtu siç shprehen se kanë nevojë të trajnohen për të ngritur kapacitetet e tyre se si mund ti bindin qytetarët të marrin pjesë në dëgjuesat publike.

7. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë

Janë realizuar 6 intervista me punonjës të Administratës së Bashkisë Vau Dejës në pozicione drejtuese si NenKryetar, Përgjegjës Sektori apo specialistë të fushës.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje të nëpunësve të Bashkisë situatën aktuale të





pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.


Nga intervistat rezulton se të intervistuarit kanë qenë me pjesëmarrje në mënyrë të barabartë mes burrave dhe grave.

Rëndësia e Njoftimit, Informimit dhe Konsultimit

Të intervistuarit u pyetën mbi rëndësinë që ka njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore. Siç rezulton edhe nga grafikët punonjësit e intervistuar janë shprehur ndryshe në lidhje me rëndësinë që ka njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore.




Ashtu siç rezultojn edhe nga grafiku ,17 % e të intervistuarve e konsiderojnë të rëndësishëm njoftimin në vendimarrjen vendore, ndërsa 83% e konsiderojnë shumë të rëndësishëm. Po kështu, 33 % e të intervistuarve e konsiderojnë të rëndësishëm informimin në vendimarrjen vendore, ndërsa ,67% e konsiderojnë shumë të rëndësishëm.




Ashtu siç rezultojn edhe nga grafiku, 50 % e të intervistuarve e konsiderojnë të rëndësishëm konsultimin në vendimarrjen vendore, ndërsa 50% e konsiderojnë shumë të rëndësishëm.

Kuadri ligjor

Vlerësimi mbi rëndësinë e të gjitha këtyre proceseve që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, kërkon dhe njohje të mirë të nepunësve të bashkive me aktet ligjore përkatëse. Të pyetur nëse e njohin bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore, të intervistuarit u përgjigjen se e njohin shumë mire, mire dhe disi.



Sic rezulton edhe nga grafiku kemi përgjigje të ndryshme nga ku 17% e të intervistuarve shprehen se e njohin disi bazën ligjore për njoftim, konsultim dhe informim, 33% shprehen se e njohin shumë mire këtë bazë ligjore, ndërsa ,50% shprehen se e njohin mire bazën ligjore për informimin, njoftimin dhe konsultimin ne vendimarrjen vendore.



Zbatimi i kuadrit ligjor kërkon jo vetëm njohje por dhe vlerësim të tij. Ashtu siç rezulton edhe nga grafiku 17% e të intervistuarve shprehen se kuadri ligjor është i qartë dhe plotë, ndërkohe 83% e të intervistuarve e konsiderojne kuadrin ligjor të qartë por jo të plotë.

Të intevistuarit kanë vënë theksin tek njoftimi, informimi i qytetarëve për mbledhjet dhe vendimarrjen e Këshillit Bashkiak si dhe tek nevoja e ngritjes së një zyre të posacme për transparencën në Bashki.

Ekzistenca e koordinorit për konsultimin publik dhe transparencën

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike. Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë. Të intervistuarit në bashki janë përgjigjur në masën 83% se ka një Koordinator për njoftimin dhe konsultimin me publikun në Bashki, ndërsa 17% e të intervistuarve janë shprehur jo, duke e konsideruar që nuk mbulon vetëm këtë pozicion.



Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Vau Dejës të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik janë të publikuara.

Mjetet për njoftimin e qytetarëve


Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Vau Dejës duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Format e ndarjes së informacionit me qytetarët realizohen nëpërmjet:

lajmërimeve publike të afishuara në ambientet e bashkisë,

lajmërim në mediat audiovizive,

lajmërim në mediat sociale si Facebook etj.

Vihet re se lajmërimet individuale nëpërmjet postës, dhe postës elektronike, kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara dhe web, dëgjesa publike, sondazhe etj.




Regjistri Elektronik në Bashkinë Vau Dejës

Nga monitorimet në faqen Web të bashkisë është i publikuar regjistri elektronik i cili duket i plotë dhe i ndarë në disa kategori si më poshte:


- Regjistrin për ankesa, kërkesa e Këshillit,
- Regjister i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave të qytetarve,
- Regjistri i projekt akteve për konsultim publik të Këshillit Bashkiak,
- Regjistri i Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak,
- Regjistri i projektakteve për konsultim publik të këshillit bashkiak,
- Regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të këshillit.

Nga anketimet e kryera rreth 100% janë në dijeni të ekzistencës së regjistrit elektronik dhe publikimit të tij online. Po ashtu nga vëzhgimet e kryera rezulton se ky regjistër përditësohet nga zyra e teknologjisë pasi informacioni i shkon nga departamentet përkatëse.



Mjetet e informimit për qytetarët


Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Vau Dejës për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e këndeve të informimit në ambientet e bashkisë, faqja zyrtare e bashkisë si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve.



Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve janë zyrat me një ndalesë 20%. Rregjistri elektronik (20%) si detyrim ligjor për publikimin e informacioneve që lidhen me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik si dhe bashkëpunimi me mediat lokale për ndarje informacionesh duke i parë ato si një nga platformat më të ndjekura nga qytetarët (40%). Ndërsa, materialet informuese fletëpalosje etj, (20%) është ndër format më pak të përdorura për informimin e qytetarëve dhe botimet e bashkisë të cilat nuk janë të përdorura.

Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut, ato kanë shprehur se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm.


Aksesi i qytetarëve në dokumenta /informacione




Të anketurit janë pyetur mbi aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme dhe në masën 100% ato janë përgjigjgur se në Bashkinë Vau Dejës informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm. Tek zyrat me një ndalesë është koordinatorja për të drejtën për informim që i mundëson qytetarëve për tu njohur me informacionin publik brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me ligj. Institucioni po ashtu e ka për detyrë të prodhojë dhe të publikojë informacion mbi punën e Bashkisë i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarin.

Publikimi i akteve në faqen zyrtare


Në faqen zyrtare WEB të bashkisë në menunë “Regjistri i akteve” janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Nga minitorimi in Web-it të Bashkisë konstatohet se janë më pak të publikuara aktet e kryetarit. Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme.





Programi transparencës

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.



Të intervistuarit u shprehën në masën 100% se bashkia harton programin e transparencës. Nga monitorimin rezulton se Bashkia publikon dokumenta që ka detyrim ligjor në baze të programit të transparencës për të publikuar por nuk konstatojmë të publikuara raporte në lidhje me transparencën..

<https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/Transparenca.pdf> }

Trajnimet mbi detyrimet ligjore mbi informimin publik

Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut ku rreth 60% janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 40% nuk kanë marrë trajnime.

Po ashtu, ato janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla trajnime si për qytetarët ashtu dhe për nëpunësit.

Njohja më e mirë e ligjit nga ana e tyre do sillte përmirësime dhe kualitet në mënyrën e kuptimit dhe informimit adekuat

8. Konkluzione

- Procesi i njoftimit, informimit dhe konsultimit publik, vlerësohet nga institucioni i Bashkisë Vau Dejës dhe Këshillit Bashkiak si një proces shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm me qëllim që të kontribuojë në rritje të transparencës dhe të rrisë pjesëmarrjen në procesin vendimarrjes së qytetarëve.
- Strukturat kryesore në bashki të cilat ndihmojnë në informimin e publikut, marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhënien me mediat si dhe punonjësi të caktuar për të drejtën e informimit si koordinatorë.
- Bashkia Vau Dejës i ndërton komunikimet publike me qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me anë të medias massive audio-vizive apo sociale.
- Këshilli bashkiak i zhvillon mbledhjet e hapura dhe një pjesë e mire e tyre zhvillohen dhe transmetohen on line. Mbledhjet njoftohen në faqen zyrtare të fb të KB ku përfshihen edhe njoftimi për mbledhjet e komisioneve. KB është mjaft pozitiv në qasjen dhe marrëdhënien me qytetarët.

9. Rekomandime

- Realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë të thellë për përmirësime, pasi duhet të nxiten qytetarët të marrin pjesë sa më shumë në diskutime publike dhe jo vetëm të ftuar apo punonjës të administratës. Gjetja e një mënyrë atraktive për publikun dhe qytetarët është shumë e nevojshme. Takimet duhet të realizohen gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në prag të hartimit të projekt buxheteve.
- Bashkia duhet të përdorë dhe të përditësojë sa më shumë mjetet e saj të komunikimit si dhe të përdorë median lokale të Shkodrës në mungesë të asaj në Vau-Dejës ,si pjesë e rëndësishme për të aksesuar tek komunitetit.
- Faqja zyrtare web Bashkia Vau Dejës ka nevojë për përditësim të të dhenave dhe informacionit.
- Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve ka krijuar vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shume qytetare. Krahas ngritjes se kapaciteteve të stafeve për përdorimin e këtyre shërbimeve të dixhitalizuara, duhet të bëhet e mundur që ato të lehtësojnë aksesin e qytetarve në këto shërbime.

